



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENT" (ish-Banka e Ljublanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 736/22

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, nenit 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej: Kimete Gashi - Kryetare, Vjosa Gradinaj Mexhuani Anëtare dhe Vedat Poterqoi Antarë, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik (OE) "As Teh" sh.p.k ,me seli ne Prishtinë, lidhur me aktivistin e prokurimit me titull: "Instalimi dhe mirëmbajtja e elektrikes në Institucionet Arsimore Lot 2", nr.prokurimit,616-22-10299-2-2-1,iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Prishtinës, me datë 20.01.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa e operatorit ekonomik, "As Teh" Sh.P.K ,me seli ne Prishtinë, e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me numër protokollit 736/2022 me datën 02.12.2022,për aktivitetin e prokurimit me titull: "Instalimi dhe mirëmbajtja e elektrikes në Institucionet Arsimore Lot 2", nr.prokurimit 616-22-10299-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Prishtinës.

II. Mbetet në fuqi, njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për anulimin e procedurës së prokurimit për aktivitetin e prokurimit nr.prokurimit,616-22-10299-2-2-1 Llot 2.

III. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues të OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, të precizuar me numër dhe datë si në paragrafët paraprak të dispozitivit të këtij vendimi.

IV. OSHP mund të ndërmarr masa ndaj AK për mos respektim të vendimit, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/ L-068, dhe Ligjin 05/L-092.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues, “As Teh” Sh.P.K ,me seli ne Prishtinë refuzohet si e pabazuar ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Komuna e Prishtinës në cilësinë e autoritetit kontraktues me datën 18.11.2022, ka publikuar njoftimin mbi vendimin për anulim për aktivitetin e prokurimit “Instalimi dhe mirëmbajtja e elektrikes në Institucionet Arsimore Lot 2”,nr.prokurimit,616-22-10299-2-2-1,iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Prishtinës.

AK ka parashikuar afatin për dorzimin e ofertave me datën 12.10.2022,kërkesa për ri shqyrtim në AK me datë 23.11.2022

I pakënaqur me vendimin e AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim, OE ankues “As Teh” sh.p.k ,me seli ne Prishtinë, me datën 02.12.2022 ka parashtruar ankesë në OSHP, ankesë kjo e protokolluar në OSHP me dt.02.12.2022.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: Kontratë Publike Kornizë, me një Operator Ekonomik vlera e parashikuar e kontratës: 20,000.00 €.

Me rastin e shqyrtimit paraprak, Paneli Shqyrtues konstatoi se, ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrorë ankesë në OSHP vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesi e ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse po ashtu ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe e njëjta bije nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

OSHP ka angazhuar ekspertin e jashtëm shqyrtues të prokurimit që në pajtim nenin 113 të LPP-së, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore i cili në raportin e datës 22.12.2022 ka rekomanduar që:

- aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa e OE ankues “As Teh” sh.p.k në Prishtinë
- të mbetet në fuqi vendimi i datës 18.11.2022 mbi anulimin e procedurës për Llot 2.

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtrirat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE Ankues "As-Tech sh.p.k" Prishtinë

Eksperti shqyrtues pas shqyrtimit të dosjes së tenderit, pretendimet ankimore të Operatorit Ekonomik ankues, raportit të vlerësimit dhe rrjedhës së procedurës së tenderimit sqaron si ne vijim:

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimet e Operatorit Ekonomik ankues në ankesën e dorëzuar në OSHP si dhe deklaratën detale mbi faktet dhe argumentet e paraqitura Eksperti shqyrtues sqaron se Autoriteti Kontraktues ka publikuar tenderin me datën 26.09.2022 si kontratë publike kornizë, me një operator ekonomik, procedure e hapur, Tenderi i përgjegjshëm me çmimin me të ulet duke u bazuar në poentim.

Autoriteti Kontraktues gjatë përpilimit të listës së çmimeve për Llot 2 ka poentuar të gjitha pozicionet me 100% të vlerës së poentuar.

Komisioni i vlerësimit me datën 16.11.2022 ka dorëzuar raportin e vlerësimit ku rekomandon që tenderi të anulohet për shkak se çmimet janë kategorizuar në kundërshtim me kërkesat e dosjes së kontratave publike kornizë dhe AK rrjedhimisht edhe merr vendimin për anulimin e procedurës tenderuese me datën 18.11.2022.

Operatori Ekonomik ankues në pretendimin e tij ka deklaruar se AK-ja ka shkelur Neni 27.16 i RRUOPP. Eksperti shqyrtues sqaron se duke u bazuar në Rregulloren e Prokurimit Publik 001/2022 Neni 54.15 Kurdo që Autoriteti kontraktues nuk dinë sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshën në bazë të rëndësisë së secilës "kategori të shërbimeve" ose secilit "artikull" në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulet në këto raste nuk vlen pragu apo tavani plus/minus tridhjetë përqind (30%), si p.sh. mirëmbajtje të veturave, mirëmbajtje të gjeneratorëve etj, në këto raste në hapje publike të ofertave lexohet çmimi total i poentuar (peshuar) i cili shërben vetëm për qëllim të vlerësimit të ofertave ndërsa kontrata lidhet me çmime për njësi dhe mund të realizohet deri në vlerë të parashikuar. Shuma e sigurimit të ekzekutimit të kontratës në këto raste duhet të përcaktohet si shumë fikse. Kontratat me çmime për njësi mund të udhëhiqen për të gjitha llojet e kontratave, kontratë për furnizime, shërbime dhe punë (riparime dhe mirëmbajtje).

Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me RRPP 001/2022 në rastin kur nuk e ka përcaktuar peshën në bazë të rëndësisë së secilës kategori të shërbimeve sikurse kërkohet me RRPP 001/2022.

AK-ja me datën 04.11.2022 ka kërkuar sqarime shtesë ne ofertën e OE MVR Elektromontues ne lidhje me 4 pozicione te cilat komisioni ka vlerësuar se janë mete larta se çmimet e tregut, OE ju ka përgjigjur me datën 08.11.2022 duke arsyetuar pozicionet të cilat janë konsideruar si çmime të larta. Përkundër faktit se OE kishte kthyer përgjigjen ai nuk ishte informuar me vendimin e AK-se nëse sqarimet shtesë të tij kanë qenë apo jo të pranueshme. Për më tepër komisioni i vlerësimit ka bërë vlerësimin e të gjitha ofertave por AK-ja nuk i ka informuar OE për rezultatin e vlerësimit të ofertave të tyre për Llot 2 por vetëm nxjerr vendimin se procedura është anuluar.

AK-ja ka vepruar në kundërshtim me nenin 40.3 të RRPP 001/202240.3 Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, dhe nxjerrja e njoftimit mbi vendimin e AK, do të kryhet nga AK brenda periudhës me të shkurtër te mundshme kohore dhe jo me shume se 30 dite nga hapja e ofertave. Vetëm ne raste të jashtëzakonshme dhe të arsyetuara, ne veçanti për kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhe mund të zgjatet për një afat shtese prej 20 ditësh. Procesi i vlerësimit të tenderit do të filloje menjëherë pas përfundimit të procesit të hapjes se tenderëve.

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në analizën e fakteve dhe dëshmive të dokumentuara ne sistemin e prokurimit, raportin e vlerësimit të komisionit, vendimet e AK-se ne lidhje me procedurën konstaton se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 54.15 Kurdo që Autoriteti kontraktues nuk din sasisë indikative, kontratat me çmime për njesi, AK duhet të përcaktoj peshet ne baze te rëndësisë se secilës "kategori të shërbimeve" ose secilit "artikull" si dhe nenit 40.3 te RRPP 001/2022.

Prandaj për shkak të natyrës se shkeljeve eksperti shqyrtues vlerëson se në këtë fazë nuk mund të behët përmirësimi i procedurës së prokurimit dhe rrijedhimisht duhet vepruar ne përputhje me nenin 21.7 Njoftim për informata shtesë ose përmirësim gabimi

d. Nëse ndonjë përmirësim i gabimit ose informacion shtese shpie në një ndryshim rrënjësor të kushteve të parashikuara në njoftimin origjinal të kontratës dhe ZPP e konstaton se ka një ndryshim rrënjësor ZPP duhet të anuloj aktivitetin e prokurimit dhe të ri-shpall të njëjtin nëse ende ka interes për të vazhduar me aktivitetin e njëjtë të prokurimit.

Përfundim:

Eksperti shqyrtues pas analizimit te pretendimit të Operatorit Ekonomik ankues, shqyrtimit te dosjes e tenderit, përshkrimit të çmimeve, vlerëson se pretendimi i OE ankues është pjesërisht i bazuar.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar ne sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar, dhe të mbetet në fuqi vendimi i datës 18.11.2022 mbi anulimin e procedurës për Llot 2.

Ne rast të ri-tenderimit AK-ja duhet të veproje në përputhje me LPP-ne dhe RRPP 001/2022 dhe të evitoje shkeljet e evidentuara ne këtë procedure tenderuese.

Konform nenit 24 paragrafi 1 i Rregullores së Punës së OSHP-së 01/ 2020 e datës 03. 03. 2022 (e amandamentuar), paneli shqyrtues ka vlerësuar se në shkresat e kësaj lënde ka argumente dhe prova të mjaftueshme që vendimi meritohet të merret edhe pa dëgjimin e palëve në seancë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi sqaron, se:

PSH konstaton se AK në njoftimin mbi vendimin ka ofruar informatat të cilat shpjegojnë arsyet përkatëse të anulimit ku shkak të parregullsive ose përndryshe tenderit të papërshtatshëm duke gjetur magësitë në përpilimin e DT, e cila në këtë rast është përpiluar në kundërshtim me dispozitat ligjore të Rregullores së Prokurimit Publik 001/2022 Neni 54.15.

PSH konstaton se AK gjatë përpilimit të kërkesave në DT duhet të përcaktoj peshën në bazë të rëndësisë së secilës "kategori te shërbimeve" ose secilit "artikull" ne mënyrë që AK të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët në këto raste nuk vlen pragu apo tavani plus/minus tridhjetë përqind (30%), si p.sh. mirëmbajtje të veturave, mirëmbajtje të gjeneratorëve etj. në këto raste në hapje publike të ofertave lexohet çmimi total i poentuar (peshuar) i cili shërben vetëm për qëllim të vlerësonit të ofertave ndërsa kontrata lidhet me çmime për njësi dhe mund të realizohet deri në vlerë të parashikuar.

- Përfundim -

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 7 dhe 62 të LPP. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast nuk përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse, vlerësimi i ofertave nuk do të mund të bëhet në mënyrë të drejtë dhe bje ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, për shkak të natyrës se shkeljeve gjatë përpilimit të DT, PSH vlerëson se në këtë fazë nuk mund të bëhet

përmirësimi i procedurës së prokurimit dhe rrjedhimisht nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Paneli shqyrtues, nëse evidenton se zyrtari përgjegjës i prokurimit, në të ardhmen, bënë gabime tjera të tilla dhe të rënda, sikur ky, atëherë OSHP me një shkresë do ti drejtohet KRPP-së, dhe do të kërkojë që të veprojë konform nenit 25 të LPP-së, për anulim të certifikatës së prokurimit.

Andaj nga te lartcekurat, paneli shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetarija e Panelit Shqyrtues
Kimete GASHI



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 Komuna e Prishtinës

1x1 "As Teh" sh.p.k ,me seli ne Prishtinë,

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.